

Të nderuar pjesëmarrës,

INSTAT në vitin 2020 do të kryejë Censin e Popullisë dhe Banesave i cili është një nga operacionet statistikore më të mëdha në vend. Censi si i tillë kërkon angazhimin e shumë burimeve humane dhe financiare për të arritur standarde e kërkuara ndërkombëtare.

Instituti i Statistikave, në këtë operacion statistikore ka angazhuar të gjithë stafin e tij për të zhvilluar me seriozitetin maksimal këtë proces statistikor, i cili jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, konsiderohet më i rëndësishmi në vend nga pikëpamja e llojit të informacionit statistikore që ai mbledh. Censi është bazë për përmirësimin e të dhënave socio-ekonomike në vend dhe ndërtimin e një sistemi të shëndoshë statistikor.

INSTAT është duke punuar intesivisht më të gjitha hallkat që do të angazhohen në këtë proces me qëllim që ky Cens të jetë sa më afër, jo vetëm realitetit shqiptar por edhe standardeve ndërkombëtare.

Gjatë muajve të fundit INSTAT ka zhvilluar një sërë tryezash të rrumbullakëta me grupet e interesit, për draftimin e pyetësorit të Cens, me qëllim evidentimin e kërkesave, vërejtjeve apo sugjerimeve të këtyre grupeve. Këto takime, do të vijojnë edhe më tej në të ardhmen për të patur një pyetësor jo vetëm me standarde ndërkombëtare por edhe gjithëpërfshirës me përdoruesit vendas të të dhënave të Censit.

Ne kërkojmë që procesi i hartimit të pyetësorit të jetë transparent dhe i dakordësuar me qëllim që proceset e mëtejshme të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave mos të jenë të kontestueshme duke arritur standardet ndërkombëtare.

INSTAT do të kryejë një prezantim mbi tri pyetjet që konsiderohen sensitive, ajo e përkatësisë fetare, grupit etno-kulturore dhe gjuhës amtare për të dakordësuar dhe marrë nga ju opinione të vlefshme deri në finalizimin e pyetësorit.

Kontributi juaj do të jetë mjaft i vlefshëm për ndërtimin e një pyetësoi, të pranueshëm dhe me standarde ndërkombëtare.

Faleminderit!